



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 19.03.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK 2017 PËR PROJEKTIN “ZHVILLIM I QËNDRUESHËM I ZONAVE RURALE”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 19.03.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

II. Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji ka si qëllim, ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale”.

Marrëveshja që propozohet përmes këtij projektligji, mbështetet në marrëveshjen bazë, Gjermano-Shqiptare të datës 21 tetor 1988, mbi bashkëpunimin teknik. Ajo vjen në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore mes dy vendeve, bazuar në dëshirën për ti thelluar e forcuar këto marrëdhënie miqësore edhe nëpërmjet bashkëpunimit teknik e financiar si partnerë. Këto elementë, që përbëjnë dhe bazën e kësaj marrëveshjeje si dhe referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr.294/2017), vlerësohet se do të kontribuojnë, në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit tonë.

Projekti “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale”, ka si objektiv të ofrojë shërbime në personel dhe materiale si dhe kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh.

Marrëveshja është organizuar në 5 nene gjithsej dhe ka respektuar aspektin formal të një marrëveshjeje.

Në nenin 1 të saj, përcaktohet objekti i marrëveshjes, detajohen elementët financiar dhe të bashkëpunimit teknik që ofron Qeveria e Republikës Federale Gjermane, kushtet garantuese ndaj Këshillit të Ministrave të Qeverisë Shqiptare si dhe përcaktimet dhe afatet përkatëse lidhur me mos zhvlehtësimin pa kompensim të premtimit financiar.

Në nenin 2, përcaktohet detyrimi për nënshkrimin e kontratave të veçanta të zbatimit dhe eventualisht financimit mes strukturave të ngarkuara për zbatimin e saj.

Në nenin 3, renditen të gjitha lehtësirat fiskale të afuara nga Qeveria Shqiptare lidhur me përjashtimin e materialeve, automjeteve, mallrave, pajisjeve si dhe vetë organizatën nga detyrimet tarifore të importit, tarifat e licencave, taksat portuale, të magazinimit etj., si

dhe përcaktohet, detyrimi për të rimbursuar vlerën e TVSH-së apo taksave të ngjashme indirekte që mund të jenë mbajtur në RSH.

Neni 4, rivendos vlefshmërinë e marrëveshjes dhe të termave të marrëveshjes së 1988 edhe në këtë marrëveshje, ndërsa neni 5 i saj trajton hyrjen e saj në fuqi duke përcaktuar si datë të hyrjes në fuqi, ditën kur Këshilli i Ministrave i RSH njofton Qeverinë e Republikës së Federatës të Gjermanisë, për plotësimin e kushteve të brendshme për hyrjen në fuqi.

IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, shpjegoi se, marrëveshja është miratuar në parim me VKM nr. 739, datë 12.12.2018, është nënshkruar nga palët më 27.12.2018 dhe bazuar në nenin 17 të ligjit të 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare” i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë për ratifikim.

Projekti “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale”, ka si objektiv të ofrojë shërbime në personel dhe materiale si dhe kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh.

Mundësimi i finalizimit të këtij projekti, paraqet një interes të shtuar për vendin tonë, në kuadrin e bashkëpunimit teknik si partnerë. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme, klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të projektit si dhe do kujdeset për kryerjen e shërbimeve të nevojshme nga institucionet e ngarkuara për zbatimin e tij.

Premtimi financiar për projektin e bashkëpunimit teknik si dhe shuma përkatëse do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda 4 viteve, pas vitit të premtimit financiar, nuk është lidhur ende kontrata përkatëse e zbatimit si dhe eventualisht kontrata e financimit. Për këtë shumë afati përfundon në datën 31 dhjetor 2021.

Detajimet e termave të projektit, si dhe ato mbi detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta, zbatimi dhe financimi, të cilat do të lidhen ndërmjet institucioneve që janë ngarkuar ose do të ngarkohen, me zbatimin e projektit. Kjo marrëveshje vlen si për projektin përkatës ashtu edhe për masa të tjera vijuese nën të njëjtin titull, nëse qeveritë e dy vendeve do të duan të mbështesin më tej projektin.

Institucioni përfitues i këtij projekti do të jetë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpjeguan në terma më teknik marrëveshjen dhe përfitimet e shumta në kuadër të këtij bashkëpunimi teknik dhe kontributin e pritshëm të saj, në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Anëtarët e komisionit, gjatë shqyrtimit të marrëveshjes, ritheksuan rëndësinë e saj dhe evidentuar frymën tepër pozitive të marrëdhënieve ekzistuese midis dy vendeve dhe dëshirën për forcim dhe thellim të kësaj marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik si partner.

V. Efektet financiare

Efektet financiare të kësaj marrëveshje konsistojnë në pagesën e TVSH-së në masën rreth 200 000 euro, shumë kjo që do të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

VI. Përfundime

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe duke vlerësuar, përfitimet e shumta në kuadër të këtij bashkëpunimi teknik dhe kontributin e pritshëm të saj, në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

RELATOR

Arben AHMETAJ

KRYETAR

Arben AHMETAJ